



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ANALIZA E PËRMBUSHJES SË CAQEVE PËR 6 MUJORIN E VITIT 2017 NGA PROCESI RREGULLATOR I TARIFAVE 2015-2017



DT/ARRU

Prishtinë, shtator 2017

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efëiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Misioni

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”.

PËRMBAJTA

KAPITULLI 1

QASJA DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

KAPITULLI 1	6
1 PARATHËNIE	7
2 Qëllimi i raportit	8
3 Metodologjia e vlerësimit të caqeve	9
KAPITULLI 2	10
1. Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët	11
1.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve	12
2. Analiza e shpenzimeve operative	14
2.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura	15
2.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura	16
3. Analiza e faturimit dhe arkëtimi në vlerë monetare	17
3.1 Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura	18
3.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të ndotura	19
3.3 Shuma e arkëtitimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura	20
3.4 Paraqitja grafike e arkëtitimit për ujë dhe ujëra të ndotura	21
4. Analiza e investimeve kapitale	22
4.1 Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake	23
4.2 Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive	26
4.3 Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët	27
4.4 Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët	30
KAPITULLI 3	31
1. Analiza e humbjeve të ujit	32
2. Sasia e ujit e cila kthehet në para	33
3. Shpenzimet e pagave	34
4. Shpenzimet e energjisë elektrike	35
KAPITULLI 4	36
1. Rangimi i KRU-VE SIPAS REALIZIMIT TË CAQEVE	37
1.1 Rangimi individual sipas kriterit të përmbushjes së caqeve	39

1.2 Rangimi i KRU-ve sipas realizimit të caqeve	46
2. KONKLuzionet e Raportit	47

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve
DRP	Departamenti për raportim të performancës në ARRU
DT	Departamenti i Tarifave në ARRU
FE	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Bifurkacioni" sh. a – Ferizaj
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Radoniqi" sh. a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidromorava" sh. a – Gjilan
GSJP	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetës
MIT	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidrodrini" sh. a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina" sh. a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidroregjioni-Jugor" sh. a – Prizren
U.N	Ujëra të ndotura

KAPITULLI 1

QASJA DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

1 PARATHËNIE

Sipas praktikave të mira të përvetësuara nga ARRU edhe kësaj radhe kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin e gjashtë mujorit të parë të vitit 2017, të 27-in me radhë, vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve, të procesit rregullatorë të tarifave afatmesme 2015-2017. Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së veçantë të shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, me të cilën vlerësohet shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të tarifave për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Për t'u përpiluar ky raport, fillimisht janë marrë të dhënat e aprovuara nga procesi tarifar 2015-2017, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017, të cilat njëkohësisht paraqesin të dhënat bazë përmes të cilave vlerësohet afarizmi i të gjitha KRU-ve në Kosovë. Më pastaj, janë paraqitur të dhënat e realizuara nga KRU-të për të njëjtën periudhë kohore të vitit 2017 për krahasim me të dhënat e aprovuara nga ARRU. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në sektor, në këtë raport janë paraqitur edhe të dhënat historike të cilat kanë ndodhur në 6 mujorin e vitit 2017.

Rëndësia e monitorimit të KRU-ve, që ndërlidhet me performancën e tyre karshi objektivave të përcaktuar përgjatë procesit tarifar, me theks të veçantë monitorimin periodik të afarizmit të KRU-ve, është shprehur edhe në raportin e Grupit për Studime Juridike dhe Politike mbi Llogaridhënien e Institucioneve të Pavarura në Kosovë. Sipas këtij raporti, në mesin e indikatorëve për vlerësimin Rregullatorëve në Kosovë, ekziston edhe një indikator për "vlerësimin periodik të performancës, për çka ARRU ka marrë poena maksimal. Ndër të tjera, raporti në fjalë ka shpallur ARRU-në si institucionin më të suksesshëm në këtë aspekt.

Ky vlerësim nga GSJP, e mbështet edhe më tutje qasjen e DT që ka aplikuar ndër vite në monitorimin e afarizmit periodik të KRU-ve.

2 QËLLIMI I RAPORTIT

Procesi tarifor që udhëheq ARRU paraqet një tërësi komplekse të informatave të ndryshme të KRU-ve, përmes të cilave jo vetëm që caktohen tarifat për shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura, por aty determinohen edhe një mori të dhënash operative, financiare dhe të investimeve kapitale që i arsyetojnë ato tarifa.

Prandaj ne me të drejtë themi se monitorimi i këtyre të dhënave të aprovuara nga ARRU janë të një rëndësie të veçantë për të përcjellë afarizmin e KRU-ve për periudhën e shikuar kohore.

Në anën tjetër, KRU-të deri më tani nuk janë treguar shumë të vëmendshme për t'a përcjellë deri në fund përmbylljen e procesit tarifor. Ka pasur raste me disa prej KRU-ve, që pasi është përfunduar procesi tarifor, nuk kanë qenë të sigurt për të dhënat operative dhe financiare që janë aprovuar nga ARRU. Në raste të tjera, KRU-të kanë përdorur të dhëna tjera në planet e tyre të biznesit, dhe jo ato të cilat ka aprovuar ARRU. Kjo më tepër e shfaq rëndësinë kur dihet se me ligjin e ri të ARRU-së, të gjitha KRU-të në Kosovë duhet të dorëzojnë për aprovim tek ARRU biznes planet e tyre.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, qëllimi i këtij raporti është :

- (i) T'i rikujtoj KRU-ve, e para e punës, se vlerësimi i përmbushjes së caqeve bëhet vetëm me të dhënat e aprovuara gjatë procesit tarifor, dhe se në momentin kur ato aprovohen ato mbasin si të tilla, përveç të ndonjë rishqyrtimi të jashtëzakonshëm të tarifave.
- (ii) Të jepet informacion për shkallën e arritjes së caqeve operative dhe financiare të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për periudhën e shikuar kohore të vitit 2017.
- (i) Krahasoni i treguesve të KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tarifor të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve t'u mundësohet KRU-ve të ndërmarrin veprime të duhura me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendet e tilla deri në përfundim të vitit 2017 nga procesi rregullatorë i tarifave 2015-2017.
- (ii) E fundit, por jo për nga rëndësia, ky raport ka si për qëllim t'i sensibilizojë menxhmentin e ARRU-ve që me rastin e aplikimit të procesit tarifor për tarifa të reja, të jenë më aktiv dhe më të vëmendshëm pasi që një performancë e mirë e përmbushjes së caqeve ndërlidhet edhe me një planifikim adekuat.

3 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifar 2015-2017 për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017, është uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënave të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabela përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënave, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016,
- të dhënat e aprovuara nga ARRU për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017,
- të dhënat e realizuara nga KRU për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017,
- përqindja krahasuese për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 me periudhën e njëjtë të vitit 2016,
- përqindja krahasuese e realizimit të caktuar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017, dhe
- vlerësimi përfundimtar.

Përqindja krahasuese për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2016 fitohet duke pjesëtuar të dhënat e vitit 2017 me të dhënat e vitit 2016 të periudhave të shikuara dhe të shumëzuar me 100. Përqindja krahasuese e realizimit të caktuar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 del si rezultat i pjesëtimit të të dhënave të aprovuara me të dhënat e realizuara dhe të shumëzuar me 100. Vlerësimi përfundimtar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësim i ARRU-së, dhe identifikohet si:

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat e ujit të humbur dhe shpenzimeve operative në m³.

Kufijtë	Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
< 98.00 %	T P	Tejkaluar pozitivisht plus	Pozitiv +
98.00% - 102.00%	R	E realizuar	Pozitiv
102.01%- 106.00%	P	E përafruar	Negativ
> 106.00%	Jo e R	Jo e Realizuar	Negativ -
	E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat tjera

Kufijtë	Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
> 102.00 %	T P	Tejkaluar pozitivisht plus	Pozitiv +
98.01% – 102.00%	R	E realizuar	Pozitiv
94.00% – 98.00%	P	E përafruar	Negativ
<94.00%	Jo e R	Jo e Realizuar	Negativ -
	E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

KAPITULLI 2

ANALIZA E PËRMBUSHJES SË CAQEVE

1. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT

Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve prej nga është bërë krahasimi i të dhënave të realizuara me ato historike si dhe të dhënave të realizuara me të dhënat e aprovuara, me të cilat njëherit bëhet edhe vlerësimi i përmbushjes së caqeve.


Tabela Nr. 1. Krahasimi i të dhënave të aprovuara për 6m e vitit 2017 me të dhënat e realizuara për 6m e vitit 2017 dhe të dhënat historike për periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Emri i KRU	Të dhënat operative	Njësi	Historike 6m 2016	Aprovuar 6m 2017	Realizuara nga KRU-të 6m 2017	% krahasuese 6m 2016 / 6m 2017	% real cak	Vlerësimi për 6m 2017
PR	Uji i prodhuar	m ³	22,248,615	24,282,780	24,613,050	110.63%	101.36	R
	Uji i humbur	m ³	11,649,237	11,500,000	13,890,376	119.24%	120.79	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	10,599,378	12,782,780	10,722,674	101.16%	83.88	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	116,799	130,745	137,162	117.43%	104.91	R
PZ	Uji i prodhuar	m ³	8,289,217	10,225,468	8,391,779	101.24%	82.07	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	4,770,642	5,623,490	4,906,552	102.85%	87.25	T P
	Uji i faturuar	m ³	3,518,575	4,601,978	3,485,227	99.05%	75.73	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	43,523	47,500	44,271	101.72%	93.20	Jo e R
PE	Uji i prodhuar	m ³	12,777,457	12,613,206	12,810,332	100.26%	101.56	R
	Uji i humbur	m ³	8,676,721	7,500,000	8,404,017	96.86%	112.05	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	4,100,736	5,113,206	4,406,315	107.45%	86.18	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	41,536	44,904	44,586	107.34%	99.29	R
MIT	Uji i prodhuar	m ³	12,054,768	11,437,120	13,820,436	114.65%	120.84	T P
	Uji i humbur	m ³	7,533,952	5,677,297	8,302,231	110.20%	146.24	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	4,520,816	5,759,823	5,518,205	122.06%	95.81	P
	Faturimi-Jug	m ³	2,340,155	3,420,073	3,040,143	129.91%	88.89	Jo e R
	Faturimi-Veri	m ³	2,180,661	2,339,750	2,478,062	113.64%	105.91	T P
	Konsumatorët	Nr	26,030	28,548	28,277	108.63%	99.05	R
GJA	Uji i prodhuar	m ³	7,386,187	7,526,751	7,699,039	104.24%	102.29	T P
	Uji i humbur	m ³	3,505,805	3,462,305	3,694,477	105.38%	106.71	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	3,880,382	4,064,446	4,004,562	103.20%	98.53	R
	Konsumatorët	Nr	33,540	36,804	34,680	103.40%	94.23	P
FE	Uji i prodhuar	m ³	3,600,255	3,993,214	3,667,118	101.86%	91.83	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	1,887,968	1,817,109	2,037,959	107.94%	112.15	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	1,712,288	2,176,105	1,629,160	95.15%	74.87	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	24,247	27,749	25,594	105.56%	92.23	Jo e R
GJI	Uji i prodhuar	m ³	4,000,007	4,000,007	4,292,462	107.31%	107.31	T P
	Uji i humbur	m ³	2,324,080	1,883,500	2,441,017	105.03%	129.60	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	1,675,927	2,116,507	1,851,445	110.47%	87.48	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	23,904	26,053	25,797	107.92%	99.02	R
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	70,356,506	74,078,545	75,294,216	107.02%	101.6	R
	Uji i humbur	m ³	40,348,405	37,463,701	43,676,629	108.25%	116.5	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	30,008,101	36,614,845	31,617,588	105.36%	86.35	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	309,579	342,303	340,366	109.94%	99.43	R


1.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin vizual të të dhënave historike për 6 mujorin e vitit 2016 me të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe të dhënat e realizuara nga KRU-të për 6 mujorin e vitit 2017.


Uji i prodhuar në m³




Uji i humbur në m³



Uji i faturuar në m³



Konsumatorët



Nga tabela numër 1 vërejmë se në baza sektoriale në dy nga katër treguesit e paraqitur KRU janë mirë krahasuar me të dhënat e provuara edhe atë të sasia e ujit të prodhuar, ku prodhimi në total ka tejkaluar sasinë e prodhimit të aprovuar nga ARRÜ dhe të numri i konsumatorëve, ku numri i konsumatorëve në total është përafëruar me numrin e aprovuar nga ARRÜ.

Të dhënat për ujin e faturuar dhe humbjet e ujit në nivel të sektorit nuk kanë arritur të realizojnë pritjet të cilat janë aprovuar nga rregullatori. Për t'u dalluar vlen të përmendet KRU Radoniqi e cila ka arritur të realizoj respektivisht përafërojt të dhënat e realizuara me ato të aprovuara për të gjithë treguesit e paraqitur përveç të humbjet e ujit.

2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifor 2015-2017, ARRU ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pasur shpenzime operative mbi kostot optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative të KRU-ve të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të ndotura, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ARRU (www.arru-rks.org).


2.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura për secilën KRU dhe sektorin, duke i paraqitur edhe shpenzimet operative historike për 6 mujorin e vitit 2016, ato të aprovuara nga ARRU si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2017, të cilat janë vlerësuar me shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe me vlerësimin tonë përfundimtar për këtë periudhë kohore.

Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura në €


Emri i KRU	Zërat e shpenzimeve operative	Valuta	Historike 6m 2016	Aprovuara 6m 2017	Realizuara nga KRU-të 6m 2017	%krahasese 6m 2016 / 6m 2017	% real cak	Vlerësimi për 6m 2017
PR	Ujë	€	3,951,634	4,882,808	4,302,279	108.87%	88.11%	T P
	Ujëra të Ndotura	€	121,014	274,149	131,380	108.57%	47.92%	T P
	Totali	€	4,072,648	5,156,957	4,433,659	108.86%	85.97%	T P
PZ	Ujë	€	1,329,025	1,648,658	1,468,088	110.46%	89.05%	T P
	Ujëra të Ndotura	€	140,214	156,035	285,557	203.66%	183.01	Jo e R
	Totali	€	1,469,239	1,804,694	1,753,645	119.36%	97.17%	T P
PE	Ujë	€	1,024,218	1,174,584	1,133,384	110.66%	96.49%	T P
	Ujëra të Ndotura	€	50,240	81,338	75,821	150.92%	93.22%	T P
	Totali	€	1,074,458	1,255,922	1,209,205	112.54%	96.28%	T P
MIT	Ujë	€	994,782	1,112,863	1,357,279	136.44%	121.96	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	172,147	100,891	173,673	100.89%	172.14	Jo e R
	Totali	€	1,166,929	1,213,754	1,530,951	131.19%	126.13	Jo e R
GJA	Ujë	€	1,257,916	1,302,934	1,371,140	109.00%	105.23	P
	Ujëra të Ndotura	€	47,831	158,272	50,577	105.74%	31.96%	T P
	Totali	€	1,305,747	1,461,207	1,421,717	108.88%	97.30%	T P
FE	Ujë	€	608,048	723,636	641,084	105.43%	88.59%	T P
	Ujëra të Ndotura	€	163,600	140,541	146,298	89.42%	104.10	P
	Totali	€	771,648	864,177	787,382	102.04%	91.11%	T P
GJI	Ujë	€	680,454	743,132	707,040	103.91%	95.14%	T P
	Ujëra të Ndotura	€	68,306	68,746	69,768	102.14%	101.49	R
	Totali	€	748,760	811,879	776,808	103.75%	95.68%	T P
Sektori	Ujë	€	9,846,077	11,588,615	10,980,294	111.52%	94.75%	T P
	Ujëra të Ndotura	€	763,352	979,974	933,074	122.23%	95.21%	T P
Totali i përgjithshëm		€	10,609,429	12,568,589	11,913,367	112.29%	94.79%	T P

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur për 6 mujorin e vitit 2017, 92.17% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 7.83% janë shpenzime të ujërave të ndotura. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të për 6 mujorin e vitit 2017 është 11,913,367 €, të cilat si të tilla janë nën kufijtë që ka përcaktuar ARRU, në masën prej 5.21 %, për çka vlerësohet si arritje pozitive.




2.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura


Shpenzimet operative për ujë



Shpenzimet operative për kanalizim



Përqindja e realizimit të shpenzimeve operative nga KRU-të



3. ANALIZA E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga secila kompani në veçanti dhe sektorit në përgjithësi, në të cilat hynë të dhënat historike të realizuara për 6 mujorin e vitit 2016, pastaj të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe ato të realizuara nga KRU-të gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2017, sipas procesit rregullatorë të përcaktimit të tarifave të viteve 2015-2017.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten të dhënat e aprovuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar për vitin 2017 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë të njëjtës periudhë të këtij viti me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2016.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ARRU në Maj të vitit 2017, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetrike për ujë i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim atribuohet si e vetme për shërbimin e ujërave të ndotura.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe ato për ujëra të ndotura, ARRU ka qenë e detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi i cili është konsideruar si më i arsyeshmi, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ARRU-KRU dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektorit të cilit i takojnë.

Shënim:

Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit (subvencione), që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ARRU-ës të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.

3.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura


Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare, për të dhënat historike për 6 mujorin e vitit 2016, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori për 6 mujorin e vitit 2017.

Tabela Nr. 3 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare

Emri i KRU	Të dhënat e faturimit	Valuta	Historike 6m 2016	Aprovuara 6m 2017	Realizuara nga KRU-të 6m 2017	%krahasese 6m 2016 / 6m 2017	% real cak	Vlerësimi për 6m 2017
PR	Ujë	€	6,082,512	7,168,240	6,306,299	103.68%	87.98	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	596,211	773,084	603,118	101.16%	78.01	Jo e R
	Totali	€	6,678,723	7,941,324	6,909,417	103.45%	87.01	Jo e R
PZ	Ujë	€	1,782,275	2,230,990	1,773,172	99.49%	79.48	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	213,341	264,840	213,141	99.91%	80.48	Jo e R
	Totali	€	1,995,616	2,495,830	1,986,313	99.53%	79.59	Jo e R
PE	Ujë	€	1,508,121	1,734,477	1,545,239	102.46%	89.09	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	154,405	167,425	167,124	108.24%	99.82	R
	Totali	€	1,662,526	1,901,901	1,712,363	103.00%	90.03	Jo e R
MIT	Ujë-Jugu	€	1,063,324	1,599,112	1,416,051	133.17%	88.55	Jo e R
	Ujë-Veriu	€	370,784	397,830	421,271	585097.97%	105.89	P
	Ujëra të Ndotura	€	221,589	265,273	266,339	120.20%	100.40	R
	Totali¹	€	1,284,913	1,864,384	1,682,390	130.93%	90.24	Jo e R
GJA	Ujë	€	1,565,584	1,841,719	1,772,140	113.19%	96.22	P
	Ujëra të Ndotura	€	249,426	254,908	253,364	101.58%	99.39	R
	Totali	€	1,815,010	2,096,627	2,025,504	111.60%	96.61	P
FE	Ujë	€	797,046	968,766	801,459	100.55%	82.73	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	223,073	273,970	215,839	96.76%	78.78	Jo e R
	Totali	€	1,020,119	1,242,736	1,017,298	99.72%	81.86	Jo e R
GJI	Ujë	€	787,640	936,551	868,549	110.27%	92.74	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	144,569	139,343	162,292	112.26%	116.47	P
	Totali	€	932,208	1,075,894	1,030,841	110.58%	95.81	P
Sektori	Ujë ²	€	13,957,286	16,877,683	14,904,180	106.78%	88.31	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	1,802,614	2,138,843	1,881,217	104.36%	87.95	Jo e R
Totali i përgjithshëm		€	15,389,188	19,016,526	16,785,397	106.51%	88.27	Jo e R

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë për këtë periudhë kohore, 88.79 % të shumës së faturimit në vlerë financiare realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 11.21 % rrjedh nga shërbimi i ujërave të ndotura. Në total për sektorin, për 6 mujorin e vitit 2017 është realizuar faturimi në vlerë prej 16,785,397 €, e që paraqet 88.27 % të shumës së aprovuar nga procesi rregullator për këtë periudhë kohore.

Pjesmarrja e faturimit nga uji dhe ujërat e zeza




¹ Për vlerësimin e përmbljes së caktit të KRU "Mitrovica", totali nuk përmban sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit. Por, për të qenë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturuar për atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.


² Për të ditur vlerën totale që faturohet në sektorin e ujit në Kosovë, totali në këtë pjesë përmban edhe faturimin për Veriun e Mitrovicës.

3.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të ndotura


Faturimi për ujë në euro



Faturimi për ujëra të zeza në euro



Përqindja e realizimit të faturimit në Euro



3.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura


Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare, për të dhënat historike për 6 mujorin e vitit 2016, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të për 6 mujorin e vitit 2017.

Tabela Nr. 4 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare

Emri i KRU	Arkëtimi për shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 6m 2016	Aprovuara 6m 2017	Realizuara nga KRU-të 6m 2017	% krahasuese 6m 2016 / 6m 2017	% real cak	Vlerësimi për 6m 2017
PR	Ujë	€	5,001,230	6,203,024	5,331,921	106.61%	85.96%	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	524,382	612,017	571,134	108.92%	93.32%	Jo e R
	Totali	€	5,525,611	6,815,042	5,903,056	106.83%	86.62%	Jo e R
PZ	Ujë	€	1,351,301	1,830,596	1,642,929	121.58%	89.75%	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	161,779	206,852	197,327	121.97%	95.40%	P
	Totali	€	1,513,080	2,037,449	1,840,256	121.62%	90.32%	Jo e R
PE	Ujë	€	1,092,228	1,395,688	1,167,185	106.86%	83.63%	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	111,825	138,514	127,014	113.58%	91.70%	Jo e R
	Totali	€	1,204,053	1,534,202	1,294,199	107.49%	84.36%	Jo e R
MIT	Ujë	€	619,224	1,160,693	652,737	105.41%	56.24%	Jo e R
	Subvencionet	€	130,000	247,261	86,895	66.84%	35.14%	Jo e R
	Ujërat e ndotura	€	104,498	196,343	139,722	133.71%	71.16%	Jo e R
	Totali⁴	€	723,722	1,357,036	792,459	109.50%	58.40%	Jo e R
GJA	Ujë	€	1,383,427	1,480,802	1,413,167	102.15%	95.43%	P
	Ujëra të Ndotura	€	222,135	202,335	202,379	91.11%	100.02%	R
	Totali	€	1,605,562	1,683,138	1,615,545	100.62%	95.98%	P
FE	Ujë	€	554,641	750,620	507,008	91.41%	67.55%	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	155,230	212,726	141,948	91.44%	66.73%	Jo e R
	Totali	€	709,871	963,346	648,956	91.42%	67.36%	Jo e R
GJI	Ujë	€	567,402	780,616	631,116	111.23%	80.85%	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	119,883	116,643	117,290	97.84%	100.55%	R
	Totali	€	687,285	897,259	748,406	108.89%	83.41%	Jo e R
Sektori	Ujë	€	10,569,452	13,602,040	11,346,064	107.35%	83.41%	Jo e R
	Ujëra të Ndotura	€	1,399,732	1,685,431	1,496,815	106.94%	88.81%	Jo e R
Totali i përgjithshëm		€	11,969,184	15,287,471	12,842,878	107.30%	84.01%	Jo e R

Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ARRU-së për 6 mujorin e vitit 2017, 88.35 % e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 11.65 % rrjedh nga shërbimi i ujërave të ndotura. Në total, në 6 mujorin e vitit 2017 është realizuar arkëtimi në vlerë prej 12,842,878 €, e që paraqet përbushjen e caktuar prej 84.01 % të shumës së aprovuar për 6 mujorin e vitit 2017.


Pjesmarrja e arkëtimit nga uji dhe ujërat e zeza




⁴ Subvencionet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar kostot e ujit të trajtuar me shumicë për pjesën veriore të Qytetit të Mitrovicës, nuk përbëjnë totalin në këtë pikë, por ato janë vendosur vetëm si shifër ilustrative për të informuar palët e interesit.

3.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të ndotura


Arkëtimi për ujë në euro



Arkëtimi për ujëra të zeza në euro



Përqindja e realizimit të arkëtimit në Euro



4. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2015-2017, ARRU-KRU kanë planifikuar realizimin e shumave të caktuara të investimeve, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit**, të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznesore.

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të ndotura janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznesore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** më tutje janë të ndara në investime: (i) të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, (ii) dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: (i) fabrikat për trajtimin e ujit, (ii) ndërtesat administrative, (iii) mjetet transportuese, (iv) pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të ARRU.

4.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit për 6 mujorin e vitit 2017. Më këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ARRU me ato të realizuara nga KRU-të për 6 mujorin e vitit 2017, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtar.

Tabela Nr. 5. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financiar nga burimet vetanake të KRU sipas kategorive të theksuara ma lartë për 6 mujorin e vitit 2017 shprehur në €

Emri i KRU	Kategori të Investimeve	Aprovuara 6m 2017	Realizuar nga KRU-të 6m 2017	% krahasuese 6m 2016 / 6m 2017	% real cak
PR	Resurse dhe trajtimi i ujit	633,694	1,387,395	218.94%	T P
	Distribuim	76,078	131,813	173.26%	T P
	Aktivitetet biznesore	43,764	3,782	8.64%	Jo e R
	Totali	753,537	1,522,990	202.11%	T P
PZ	Resurse dhe trajtimi i ujit	141,239	0	0.00%	Jo e R
	Distribuim	34,907	29,829	85.45%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	8,548	23,556	275.55%	T P
	Totali	184,695	53,384	28.90%	Jo e R
PE	Resurse dhe trajtimi i ujit	10,005	0	0.00%	Jo e R
	Distribuim	132,567	0	0.00%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	107,555	0	0.00%	Jo e R
	Totali	250,128	0	0.00%	Jo e R
MIT	Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	!	E pa K
	Distribuim	23,372	0	0.00%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
	Totali	23,373	0	0.00%	Jo e R
GJA	Resurse dhe trajtimi i ujit	144,269	441,505	306.03%	T P
	Distribuim	72,134	111,136	154.07%	T P
	Aktivitetet biznesore	31,018	147,341	475.02%	T P
	Totali	247,421	699,982	282.91%	T P
FE	Resurse dhe trajtimi i ujit	46,610	822	1.76%	Jo e R
	Distribuim	40,634	3,587	8.83%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	1,673	97	5.80%	Jo e R
	Totali	88,918	4,507	5.07%	Jo e R
GJI	Resurse dhe trajtimi i ujit	79,517	0	0.00%	Jo e R
	Distribuim	0	4,098	!	E pa K
	Aktivitetet biznesore	0	3,720	!	E pa K
	Totali	79,518	7,818	9.83%	Jo e R
Sektori	Resurse dhe trajtimi i ujit	1,055,336	1,829,723	173.38%	T P
	Distribuim	379,695	280,462	73.87%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	192,559	178,496	92.70%	Jo e R
	Totali	1,627,589	2,288,681	140.62%	T P

Tabela Nr. 6. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të ndotura te financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara më lartë për 6 mujorin e vitit 2017 shprehur në €

Emri i KRU	Kategori të Investimeve	Aprovuara 6m 2017	Realizuar nga KRU-të 6m 2017	% krahasuese 6m 2016 / 6m 2017	% real cak
PR	Grumbullimi i u.n	4,010	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.n	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0.0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	1,862	117	6.28%	Jo e R
	Totali	5,874	117	1.99%	Jo e R
PZ	Grumbullimi i u.n	67,984	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.n	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	0	3,278	!	E pa K
	Totali	67,984	3,278	4.82%	Jo e R
PE	Grumbullimi i u.n	23,044	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.n	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	5,267	0	0.00%	Jo e R
	Totali	28,311	0	0.00%	Jo e R
MIT	Grumbullimi i u.n	2,032	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.n	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
	Totali	2,032	0	0.00%	Jo e R
GJA	Grumbullimi i u.n	25,405	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.n	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	0	7,965	!	E pa K
	Totali	25,405	7,965	31.35%	Jo e R
FE	Grumbullimi i u.n	11,611	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.n	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	75	0	0.00%	Jo e R
	Totali	11,686	0	0.00%	Jo e R
GJI	Grumbullimi i u.n	52,588	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.n	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	0	304	!	E pa K
	Totali	52,588	304	0.58%	Jo e R
SEKTORI	Grumbullimi i u.n	186,676	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.n	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	7,205	11,663	161.87%	TP
	Totali	193,881	11,663	6.02%	Jo e R


Tabela Nr. 7. Shumat e Investimeve kapitale të financuara nga burimet vetanake të kompanive për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për 6 mujorin e vitit 2017.

Emri i KRU	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia	Historike 6m 2016	Aprovuara 6m 2017	Realizuar a nga KRU-të 6m 2017	% krahasuese 6m 2016 / 6m 2017	% real cak	Vlerësimi për 6m 2017
PR	Ujë	€	1,412,643	753,537	1,522,990	107.81%	202.11	T P
	Ujëra të ndotura	€	1,975	5,874	117	5.92%	1.99%	Jo e R
	Totali	€	1,414,618	759,410	1,523,107	107.67%	200.56	T P
PZ	Ujë	€	3,997	184,695	53,384	1335.61%	28.90%	Jo e R
	Ujëra të ndotura	€	387	67,984	3,278	846.98%	4.82%	Jo e R
	Totali	€	4,384	252,679	56,662	1292.48%	22.42%	Jo e R
PE	Ujë	€	0	250,128	0	!	!	E pa K
	Ujëra të ndotura	€	0	28,311	0	!	!	E pa K
	Totali	€	0	278,440	0	!	!	E pa K
MIT	Ujë	€	0	23,373	0	!	!	E pa K
	Ujëra të ndotura	€	0	2,032	0	!	!	E pa K
	Totali	€	0	25,405	0	!	!	E pa K
GJA	Ujë	€	105,751	247,421	699,982	661.92%	282.91	T P
	Ujëra të ndotura	€	3,537	25,405	7,965	225.19%	31.35%	Jo e R
	Totali	€	109,288	272,827	707,947	647.78%	259.49	T P
FE	Ujë	€	16,509	88,918	4,507	27.30%	5.07%	Jo e R
	Ujëra të ndotura	€	162	11,686	0	0.00%	!	E pa K
	Totali	€	16,671	100,604	4,507	27.03%	4.48%	Jo e R
GJI	Ujë	€	16,738	79,518	7,818	46.71%	9.83%	Jo e R
	Ujëra të ndotura	€	0	52,588	304	!	0.58%	Jo e R
	Totali	€	16,738	132,106	8,122	48.52%	6.15%	Jo e R
SEKTORI	Ujë	€	1,555,637	1,627,589	2,288,681	147.12%	140.62	T P
	Ujëra të ndotura	€	6,061	193,881	11,663	192.43%	6.02%	Jo e R
